



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ee.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 2342

Prishtinë, Dt. 07/07/2026

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Fizikë
Projektpropozimi	Vlerësimi i papërcaktueshmërive në ndërkrahasimin e rezultateve të dozimetrit personale përmes detektorëve TLD-100 në burime të ndryshme rrezatimi
Kandidati	Altin Mehmetaj
Mentori	Prof. Sefer Avdiaj
Ko-mentori	Prof.asoc.Gëzim Hodolli
Aprovimi i projekt propozimit	Datë: 08.09.2025
në Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr. 2938

Komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojtje të temës master, bazuar në Kërkesën nr.2302 të datës 06.07.2026 për temën "Vlerësimi i papërcaktueshmërive në ndërkrahasimin e rezultateve të dozimetrisë personale përmes detektorëve TLD-100 në burime të ndryshme rrezatimi" të kandidatit Altin Mehmetaj, në përputhje me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:

VLERËSIM TË DORËSHKRIMIT

Kandidati Altin Mehmetaj temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe kërkesat e parapara me rregullore. Punimit i paraprijnë dedikimi, falënderimi, deklarata etike dhe përmbajtja, ndërsa përfundon me diskutimin, përfundimet dhe listën e referencave. Në punim janë shfrytëzuar 15 burime bibliografike, ndërsa shtjellimi është plotësuar me figura, tabela dhe paraqitje grafike që janë të lidhura drejtpërdrejt me tekstin. Tema trajton një çështje të rëndësishme të dozimetrisë, vlerësimin e papërcaktueshmërive dhe krahasueshmërinë e rezultateve të dozimetrive personale TLD-100 në burime të ndryshme rrezatimi. Qëllimi i punimit është i formuluar qartë dhe lidhet me vlerësimin e performancës dhe besueshmërisë së sistemit dozimetrik për madhësitë operationale $H_p(10)$ dhe $H_p(0.07)$, përmes analizës së rezultateve të ndërkrahasimit.

Në kapitujt hyrës kandidati ka paraqitur bazat fizike të rrezatimit jonizues, mënyrat e detektimit, rëndësinë e testeve të ndërkrahasimit, si dhe rolin e organizimeve ndërkombëtare dhe standardeve për sigurimin e cilësisë në dozimetrit personale. Më tej, punimi shtjellon në mënyrë të strukturuar bazat fizike të termolumineshencës, teorinë zonale, kurthet energjetike dhe ndërtimin e materialit LiF:Mg,Ti (TLD-100), duke e lidhur qasjen teorike me përdorimin praktik në monitorimin profesional të ekspozimit ndaj rrezatimit.

Pjesa metodologjike e punimit përfshin përgatitjen e dozimetrave, rrezatimin e tyre në kushte të kontrolluara nga laborator standard sekondar i kalibrimit, leximin dhe përpunimin e rezultateve, si dhe analizën e faktorëve që ndikojnë në reagimin e sistemit.

Rezultatet e paraqitura në kapitullin e ndërkrahasimit tregojnë se sistemi TLD-100 ka dhënë rezultate të pranueshme për të gjitha cilësitë e rrezatimit të testuara. Për Hp(0.07), përgjigjja R është analizuar për rrezatime X, gama dhe fusha të përziera, duke rezultuar në klasifikimin "OK" sipas kriterëve të ISO 14146:2018. Për Hp(10), rezultatet gjithashtu janë brenda kufijve të pranueshmërisë, me performancë veçanërisht të mirë në regjimin W-110/60°, ku përgjigjja është afërsisht me vlerën ideale R=1.

Nga aspekti i organizimit dhe shkrimit, punimi është i strukturuar në mënyrë logjike, ka rrjedhë të qartë nga baza teorike drejt metodologjisë, rezultateve, analizës së pasigurisë dhe përfundimeve.


Në tërësi, dorëshkrimi paraqet një punë të vlefshme akademike dhe profesionale në fushën e dozimetrisë së rrezatimit. Punimi dëshmon aftësinë e kandidatit për të trajtuar një problem të rëndësishëm matës, për të interpretuar të dhënat eksperimentale dhe për të vlerësuar pasigurinë e rezultateve në përputhje me praktikën e pranuar ndërkombëtarisht.


PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMI


Punimi i tezës së masterit me titull "**Vlerësimi i papërcaktueshmërive në ndërkrahasimin e rezultateve të dozimetrit personale përmes detektorëve TLD-100 në burime të ndryshme rrezatimi**", i kandidatit **Altin Mehmetaj**, i plotëson kushtet e një teze të masterit në Fizikë. Prandaj, komisioni propozon që të vazhdohet me procedurat e mbrojtjes publike të punimit.

Prishtinë, _____

Komisioni:

1. 
Prof. Skender Kabashi – kryetar

2. 
Prof. Sefer Avdiqaj – anëtar (mentor)

3. 
Prof. asoc. Gazmend Nafezi – anëtar